

VENDIM
Nr.1247, datë 10.9.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, TË GJUHËS
ANGLEZE DHE TË INFERMIERISË SË PËRGJITHSHME, SI FILIALE TË
FAKULTETIT TË GJUHËVE TË HUAJA DHE TË FAKULTETIT TË INFERMIERISË,
TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË QYTETET E KUKËSIT DHE SARANDËS, NË
VITIN AKADEMIK 2008-2009, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E KUOTAVE TË
PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR KËTO PROGRAME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja “b”, 26, 33, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, “Gjuhë angleze”, si filial i Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, të Universitetit të Tiranës, në qytetet e Kukësit dhe të Sarandës, në vitin akademik 2008-2009.

Në përfundim të këtij programi studimi do të lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në gjuhë angleze.

2. Hapjen e programit të studimit, të ciklit të parë, “Infermieri e përgjithshme”, si filial i Fakultetit të Infermierisë, të Universitetit të Tiranës, në qytetin e Kukësit, në vitin akademik 2008-2009.

Në përfundim të këtij programi studimi do të lëshohet diplomë e nivelit të parë, DNP, në infermieri të përgjithshme.

3. Programet e studimit të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe zgjatja normale e tyre është tri vite.

4. Numri i kuotave të pranimeve, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, është, si më poshtë vijon:

- | | |
|--|-----|
| a) Programi i studimit “Gjuhë angleze”, në filialin e Kukësit; | 25; |
| b) Programi i studimit “Gjuhë angleze”, në filialin e Sarandës; | 25; |
| c) Programi i studimit “Infermieri e përgjithshme”, në filialin e Kukësit. | 60. |

5. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që regjistrohen në vitin e parë, në këto programe studimi, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti, i miratuar për Universitetin e Tiranës.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha